

Emira Ibishi

Shpresë ardhmërie

*Tetovë
2019*

E m i r a I b i s h i

Shpresë ardhmërie

Dhjetor
2019

*Veprën e parë ia dedikoj familjes të cilët më
përkrahin në çdo fushë të jetës sime pa rezervë.*

*I falemenderoj të gjithë ata që gjatë tërë
kohës më përkrahnin moralisht që të arrija deri
te botimi i veprës së parë.*

*Me respekt
Emira*

Shkollës sime

*Në qendër të fshatit
Gjendet shkolla jonë,
Shkollë kjo për bukuri
Është vendi ku nxëmë dituri.*

*Ju falemenderit mësues
Për mundin e dhënë,
Jeni dritë e syve tonë
Jeni ardhmëria jonë.*

Shkolla

Në shkollë shkojmë

Të mësojmë

Shumë dituri

Ne të fitojmë.

Shkolla ime

Sa fort të dua,

Shumë nga të drejtat

Mi mësove mua.

Mësuesët na mësojn,

Për jetë na udhëzojnë,

Rrugët më të mira

Të jetës na tregojnë.

Shkolla

*Po vjen shtatori
Me shumë hijeshi,
Te të gjithë fëmijët
Ai nxit lumturi.*

*Ejani fëmijë,
Ejani e mësoni,
Edukatë të mirë
Ju të fitoni.*

*Na munguan librat
Me shumë pikëllim,
Erdhen ditët e mësimi,
Po i presim pa durim.*

*Fjala shkollë
Ka shumë vlerë,
Gjithmonë për shkollën
Do të kemi respekt e nderë.*

Libri im

*Të lexoj, të lexoj
Shumë gjëra të reja
Nga ti mësoj.*

*Më mësove alfabetin,
Tregime e historira
Që në shkollë
Unë të jem më e mira.*

*Prej teje gjithmonë
Dituri përfitojë,
Kurr për jetë
Libri im s'të haroj.*

*Nuk të hedh kudo
Por me vete
Gjithmonë të mbajë
Se shokë më të mirë
Në botë nuk kam.*

Libri

Ai që më udhëzon

Ai që më tregon

Ai që më ndihmon

Ai që më mëson

Ai që më gëzon

Ai që më lumturon

Ai që më sqaron

Ai që më mirëkupton

Ai që brengat e jetës m'i largon

Është libri, dhe vetëm libri

Që rrugën e jetës ma mëson.

Librat

*Shumë me gëzim
Librat i shfletoj,
Lexoj shumë lexoj
Dituri të fitoj.*

*Bota pa libra
Do ishte e kotë,
Bota pa libra
Do ishte e paplotë.*

7 Marsi

O sa bukur

O sa gëzim

Erdhi shtatë marsi

Dhe në fshatin tim.

Jemi të lumtur

E shumë të gëzuar

Që erdhi shtatë marsi

Ne, për të uruar.

Ditë e madhe

Me plotë gëzim

Nxënësit urojnë

Në çdo manifestim.

Të mësuarit

*Mësoni o fëmijë
E mos rri kotë,
Sepse vlera e mësimit,
Të gjendet gjithkund në botë.*

*Pa mësim e pa dije
Je një njeri pa vetëdije,
Pa sjelle e pa edukatë
Je si një njeri i pa fat.*

Vatrës së dijes

*Në pushime kuptova
Një gjë të rëndësishme,
Më e vlefshme se
Shkolla asgjë s'kishte.*

*Shkolla është dritë
Për sytë e mi,
Ajo më edukon
Më jep dituri.*

*Sa shumë që të dua
Ty moj shkolla ime,
Gjithmonë do të kujtoj
Me mallë e kujtime.*

*Nuk dua të kalojnë vitet
Nga kjo shkollë të largohem
Nuk dua të lë prindërit e dytë
Që gjithçka më mësojnë mua.*

***E** drejta e çdo rrugw*

***M**irësia në çdo vend*

***I** sjellshëm dhe i edukuar*

***R**espekt me çdo kënd*

***A**ritje gjithmonë në atë që dëshiron.*

(Krijim akrostik)

Dua

*Dua që të luaj
E shumë pak
Dua që të vuaj,
Nuk dua dhimbjen
Nuk dua mërzinë
Dua buzëqeshjen
Dua gjithmonë lirinë.*

*Nuk dua përbuzjen
Nuk duroj sharje e ofendim,
Dua sa më pak fyerje
Dëshiroj lumturi
Në çdo fytyrë
Të sejcilit fëmijë.*

Duhet

*Duhet të mendojmë
Para se të veprojmë,
Sepse me një fjalë
Dikë shumë e lëndojmë.*

*Gabimi me vetëdije
Kur për jetë nuk falet,
Gabimin pa vetëdije
Me një fjalë të falet.*

*Kështu e ka jeta
Me veprimet e veta,
Dikush gabon
E më vonë e pëson.*

Jeta

*Jeta është për të jetuar
Sakrificat e sajë për ti kaluar
Diturinë tënde për ta shfrytëzuar
Gjëra të reja për të zbuluar.*

*Si ta shprehish diturinë
Si të përfitojsh gjithmonë lirinë
Si të veprojsh të mos gabosh
E pasoja mbrapa të mos lëshë.*

*Si të flas kur s'kam guxim
Apo të lëshohem
Në tokë pa përtim,
Apo të bërtas
Të liroj zemrën,
Apo të qajë
Të heq mërzinë,
Apo të gëzohem
Kur jam e vetmuar,
Për të gjithë njerëzit
Duke menduar.*

*Gëzohem e hidhërohem
Ndonjëherë flas me veten,
Por çdo herë ka shumë fjalë
Anë e mbanë që shpifin në çdo anë.*

Babi im

*Sa shumë që të dua,
Ty o babai im,
Mundin që e dhe për mua
Në jetë s'mund të ta shpaguej.*

*Në çdo vështërsi
Ti më ndihmove,
Rrugën më të mirë
Ti më tregove.*

Nëna

*Je një dashuri
Shumë e fortë,
Jë një përqafim
Shumë i ngrohtë.*

*Je një ëngjëll
Shumë i bukur,
Je një hare
Shumë e lumtur.*

*Je një shpresë
Që gjithmonë vazhdon,
Je një nënë që kur nuk lëndon
Je gjithçka në pafundësi
E tillë do mbetesh në përjetësi.*

Nënës sime

*Qiell i pafund je ti
Në zemrën time
Do të qëndrosh
Gjithmonë si e tillë
Nënë o nëna ime.*

*Je ma e mirë
Në gjithë botën,
Je dritë e syve të mi
Nënë o nëna ime.*

*Je yll, ndër yjet
E ndër planetet
Që jetën na ndriçojnë.*

*Se haroj mundin tënd
Asnjëherë në këtë botë,
Tërë jetën do të respektoj
Nënë o nëna ime.*

Prindërve

*A mund të marr frymë
A mund të jetoj,
Pa përqimin e prindërve
Mëngjesin nuk mund ta kaloj.*

*Nuk mund ta paramendoj
Dita të më kaloj,
Zërin e prindërve nuk mund
Nga mëngjesi pa e dëgjuar.*

*Ata janë dritë e syve të mi
Unë i dua shumë,
Për mua janë më tepër
Se gjithësi e gallaksi.*

Jetë

*A është kjo jetë
që unë po e jetoj..*

*A është ky ajër
që unë po e frymoj.*

*A është kjo ëndër
që unë po e ëndëroj.*

*A është kjo lumturi
që unë po gëzohem.*

*A është kjo shoqe
që unë po shoqërohem.*

*A është kjo histori
që unë kam kaluar.*

*A është kjo sakrificë
që unë jam duke përjetuar.*

Koha

*Koha nuk ndalon
Ne po ritemi,
Nuk jemi më fëmijë
Tani marrim vetë përgjegjësi.*

*Dielli lind e perëndon
Dita ecën dhe s'ndalon,
Jeta neve po na shkon
E gjithë bota po përfundon.*

*Ah moj kohë
Kohë me vlerë,
Ti nuk blehesh me para
E me të ofruar ty gjithçka.*

Shpresa

*Pavarësisht çdo gjëje
Shpresën nuk duhet humbur,
Duhet bërë të fortë
Asnjëherë nuk duhet dorëzuar.*

*Duhet të durojmë
Në çdo mundësi,
Sepse durimi të mundëson
Çdo herë drejtësi.*

*Dorëzim dhe humbje
Ka gjithëkund,
Guxim dhe kurajo
Nuk ka askund...*

Gënjeshtra

*Gënjeshtra është veti
E cila të duket
Se të ndihmon në vështërsi.*

*Ndoshta për një moment
Gënjeshtra të shpëton,
Më pas të vërtetën tregoje
Sepse gënjeshtra të nënçmon.*

*Me një gënjeshtrë
Ndonjë gabim e kalon,
E me shumë gënjeshtra
Bregat nuk mund ti largoj.*

Më fal

*Nuk mund
të shprehem me fjalë,
Zemra s'më lejon
Të të them më fal.*

*Të të them më fal
Me gjithë zemër,
Këto fjalë për ty
Janë shumë me zemër.*

*E di që kam gabuar
Të të kërkoj falje,
Nëse shumë
Të kam lënduar.*

E vështirë apo jo

*E vështirë nuk është të punosh
As për jetë të sakrifikosh,
Vështërsi në këtë jetë
Si parazit të jetosh.*

*Më lehtë në këtë botë
Të vërtetën të thuash ,
Se sa në jetë të heshtësh
E kurrë të vërtetën mos e tregosh.*

*Të ndjekim ëndërat tona
Nuk është dhe shumë lehtë,
Por më “lehtë” në këtë jetë
Të shkojmë pas gjërave të kota.*

Njeriu

*Njeriu në jetë
Shumë duron,
Sakrificat e jetës
Ai i përballon.*

*Nuk është e lehtë
Që të jetohet,
Duhet të përballesh
Me njerëz që tërë kohës
Merren me thash e theme .*

Krenaria

*Duhet të jemi krenar
Për atë që kemi,
Duhet të punojmë
Për atë që nuk e kemi.*

*Duhet mos lakmojmë
Për atë që s'është e jona,
Sepse gjërat e huaja
Nuk bëhen tonat.*

Pema

*Në fund të kopshtit
Dy pemë qëndrojnë,
Njëra gjallëronte
E tjetra lëngonte.*

*Gjethet ishin tharë
Pema shqetësohej
Pse gjethet
Mua të më bien.*

*Pema po qante
Lotët i shkonin
Rinte e vetmuar
Me shumë pikëllim.*

Mërgimi

*Në vendin tim
Dua të shkoj,
Në mërgim nuk mund
Të qëndroj,
Dua të nisem
Sa më shpejtë,
Nuk dua të qëndroj
Në mërgim me netë,
Dua të thith
Ajrin e tokës sime,
Dua të flas gjuhën
E nënës time,
Dua të shkoj atje
Ku u rita me thërime,
Dua të shkoj tek gjaku im
Që atje të ngelet shpirti im,
Më dhimbset rinia
Që në mërgim e kalova,
Kohën më të mirë të jetës
Në vend të huaj e harxhova,
Në vedlindje kishim varfërinë
E mbi të gjitha kishim dashurinë.*

Zogu

*Një zog i vogël
Me hare cicëron,
Këngën më të bukur
Për mua këndon.*

*Më këndoi mua
Një këngë të mirë,
Sepse unë po e dëgjoja
Këngën me dëshirë.*

Zemrimi

*Kur zemrohem
Nuk dua të flas,
Dua të mbyllem në vete
Dhe me zë të bërtas.*

*Mbyllem në një dhomë
Në katër qoshet e murit,
Aty e vetmuar qëndroj
Në dhomë tjetër nuk duroj.*

*Më pas hidhërimi
Mua më kalon,
Bregën në shpirtë
E kam përgjithmonë.*

Vështërsitë

*Nuk mund t'i arish të gjitha,
Pa mos patur vështërsi.*

*Nuk mund t'i kalosh brengat,
Pa mos patur mërzë.*

*Nuk mund të arish askund,
Pa mos patur dituri.*

Sprovë

*Çdo gjë në këtë botë
Është provë,
Gjithçka është shënuar
Se çka duhet të ndodh.*

*Duhet gjithmonë
Të bëjmë mirë,
Që mos bëhet
Sprovë e vështirë.*

*Çdo njeri i sprovuar,
Gjithmonë në shpirt
Është i lënduar.*

Pranvera

*O moj pranverë
Sa e bukur je,
Sa gëzim e hare
Ti çdo herë sjell te ne.*

*Ejani shpezë
Ejani e fluturoni,
Pranverën e bukur
Ju mos e haroni.*

Vjeshta

*Një ngjyrë e bukur
po na kaplon,
Vjeshta e bukur
po vjen në vendin tonë.
Anë e mbanë,
Po bien gjethet
Pa mbarim,
E zbukurojnë natyrën,
Me plotë zverdhërim.
Ndonjëherë me diell
E ndonjëherë me shi,
Ajër më të pastër
Nuk ka si tani.*

Skënderbeu

*Lotë, lotë me mall
E me mërzi,
Lotë gëzimi apo si,
Na mësove trimëri
O Skënderbe, me shumë fisnikëri.
Ke luftuar për komb shqiptar
Pa frikë ke mposhtur
Çdo armik që para të ka dalë.
Në çdo vend ke luftuar,
Me gjithë je përballuar.
Emri yt, në gjithë botën
Përmendet për trimëri,
O Skënderbe, o hero
Të falemenderoj shumë
Mbrojte komb, mbrojte atdhe.*

Me ty Shqipëri

*Një natë të trishtuar,
Ndodhi diçka e pa besuar.*

*Një tërmet i madh kaploi ,
Shumë pallate i rrënoi.*

*Ndalo lotin nëna Shqipëri,
Po vjen Kosova, të të ndihmoj ty.*

*Se thonë, e mira kthehet me të mirë,
Të qofshim falë ty moj Shqipëri.*

Disa fjalë rreth autores dhe veprës

“Shpresë ardhmërie” është libri e parë e Emira Ibishit të cilën e boton si nxënëse e klasës së shtatë në shkollën fillore komunale “Fan Noli” f.Trebosh. Tematika që trajton në poezitë e saja është e nduar ndurshme. Librin e fillon me poezi dedikuar shkollës, librit, festave të ndryshme shkollore e kombëtare. Duke vazhduar të krijoj edhe poezi për më të afërmit e saj, si poezi për babain , nënën. Krijon poezi të cilat ia dedikon vetes, tek të cilat paraqet gjendjen shpirtërore e emocionale të sajë. Krijon edhe poezi dedikuar jetës dhe kohës kur e ku e kalon jetën edhe Emira. E mundon largimi familjarëve në mërgim, e ndjenë edhe mungesën e Babait të saj, si mërgimtar. Ndërton vargje me rrokje të ndryshme. Po ashtu ndërton strofë me vargje të ndryshme, si p.sh., strofën dy vargëshe, strofën tre vargëshe, strofën katër vargëshe dhe strofën me shumë vargje. Përdor lloje të ndryshme të figurave letrare, si epitetin, metaforën, krahasimin etj. Në përgjithësi, krijimet e Emirës, janë reflektim i botës në të cilën jeton .

Reflekton mbi atë që e sheh dhe e kupton, e mbi to reflekton duke dhënë edhe ide se si duhet të ndryshohet edhe ardhmëria e sajë në veçanti, dhe ardhmëria e shqërisë në përgjithësi. Shpresoj se kjo nuk do të jetë libri e fundit e Emirës, mbetem me shpresë që së shpejti do të shohim në dritë edhe shumë libra të saja

Muaxher Haruni

Përmbajtja

<i>Shkollës sime</i>	4
<i>Shkolla</i>	5
<i>Shkolla</i>	6
<i>Libri im</i>	7
<i>Libri</i>	8
<i>Librat</i>	9
<i>7 Marsi</i>	10
<i>Të mësuarit</i>	11
<i>Vatrës së dijes</i>	12
<i>Dua</i>	14
<i>Duhet</i>	15
<i>Jeta</i>	16
<i>Babi im</i>	17
<i>Nëna</i>	18
<i>Nënës sime</i>	19
<i>Prindërve</i>	20
<i>Jetë</i>	21

<i>Koha</i>	22
<i>Shpresa</i>	23
<i>Gënjeshtra</i>	24
<i>Më fal</i>	25
<i>E vështirë apo jo</i>	26
<i>Njeriu</i>	27
<i>Krenaria</i>	28
<i>Pema</i>	29
<i>Mërgimi</i>	30
<i>Zogu</i>	31
<i>Zemrimi</i>	32
<i>Vështërsitë</i>	33
<i>Sprovë</i>	34
<i>Pranvera</i>	35
<i>Vjeshta</i>	36
<i>Skënderbeu</i>	37
<i>Me ty Shqipëri</i>	38
<i>Disa fjalë rreth autores dhe veprës</i>	39

Recensent: Muaxher Haruni
Kopertina dhe dizajni: Gavriilo Angeloski – Gage, Stefan
Grunevski
Rradhitjen kompjuterike: Emine Haruni
Rradhitjen teknike: Gavriilo Angeloski – Gage, Stefan
Grunevski
Shtypshkronja: Tringa Design
Tirazhi: 300



Biografi:

Emira Ibishi është nxënëse e klasës së shtatë, në Shkollën fillore komunale "Fan Noli" të f. Trebosh. Lindi në vitin 2007 në Tetovë, bashkëjeton me familjen në Trebosh. Me krijime poetike, në poezi e prozë, është marrë që në klasën e gjashtë. Ka marrë pjesë në disa gara të organizuar nga institucionet komunale. Krijimet e saja i ka të botuara edhe te faqja e shkollës. Poezia e parë e botuar në faqje të shkollës është "Libri im" me të cilën trason rrugën deri në dalje të veprës "Shpresë ardhmërie". Ka marrë pjesë edhe në shumë aktivitete të organizuara në kuadër të manifestimeve shkollore e jashta shkollore si dhe manifestime tjera në kuadër të bashkësisë vendore të f. Trebosh